



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 03.08.2012
Nr. 0204-784

PËR: Shaip Surdulli, Kryetar i Komunës së Kamenicës
Enver Mavriqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës Kamenicës

LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIM E LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS KAMENICËS, NR.01-2624 të Pranuar me datë, 13.07.2012

Të nderuar/a


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit Nr. 01-2624 për Kufizimin e Ofrimit të Shërbimeve të Komunës me Pagesën e Faturave për Mbeturina dhe Ujë të miratuar më datën 27.06.2012 nga Kuvendit i Komunës së Kamenicës **KONSTATON** se:

- Kushtëzimet për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve nga ana komunave për kryerjen e obligimeve të tyre ndaj Ndërmarrjeve Publike Komunale nuk ka bazë ligjore dhe si të tilla nuk mund të aplikohen.
- Bazuar në nenin 128 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, Shoqëria aksionare është përgjegjëse për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera me tërë asetet dhe pasurinë e saj dhe se askush nuk është përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë aksionare vetëm për shkak se është aksionare në këtë shoqëri.
- Kufizimi i shërbimeve nga komuna, për qytetarët, bizneset dhe operatorët ekonomik që funksionojnë brenda territorit të saj, më pagesën e faturave të mbeturinave për Ndërmarrjen Publike Komunale, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale *kërkon* nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Kamenicës që të ndërmarrin veprime konkrete që, Vendimit Nr.01-2624 Për Kufizimin e Ofrimit të Shërbimeve të Caktuara Komunale dhe Kushtëzimin e Ofrimit të Këtyre shërbimeve me Pagimin e Faturave për Mbeturina dhe Ujë, të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,



Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtore të Departamenteve dhe Drejtore të Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 03.08.2012
Br. 0204-784

Za: Shaip Surdulli, Gradonačelnik Opštine Kamenica
Enver Mavriqi, pRedsedavajući Skupštine Opštine Kamenica

PREDMET: ZAHTEV ZA RAZMATRANJE ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE KAMENICA, Br.01-2624 primljene dana, 13.07.2012

Poštovai-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandator odredjenom po Zakonu za Lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kancelarije Premijera i Ministarstva, posle razmatranja zakonitosti Odluke br. 01-2624 za ograničavanje pružanja opštinskih usluga sa uplatom faktura za otpatke i vodu usvojene dana 27.06.2012 od Skupštine Opštine Kamenica KONSTATATUJE da :

- Uslovljavanja za nudjenje usluga gradjanima od strane opština za izvršenje njihovih obavaza prema opštinskim javnim preduzećima nema zakonsku osnovu i kao takve se ne mogu primenjivati.
- Na osnovu člana 128 Zakona br.02/L-123 o trgovinskim društvima,akcionarskim društvima odgovoran je za sve dugove i druge obavaze sa svim asetima i svojom imovinom i niko nije odgovoran za obavaze akcionarskog društva u ovom udruženju .
- Ograničavanje usluga od opštine,za gradjane,biznese i ekonomske operatore koji funkcionišu unutar njene teritorije sa uplatom faktura za otpatke za opštinsko javno preduzeće,je u suprotnosti sa zakonodavstvom na snazi u Republiku Kosovo.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , na osnovu člana 82 tačka 2 Zakona o lokalnoj samoupravi traži od Skupštine Opštine/Gradonačelnika Opštine Kamenica da preduzme konkretne mere,da Odluka br.01-2624 o ograničenju pružanja odredjenih usluga opštine,i uslovljavanja pružanja ovih usluga sa uplatom faktura za otpatke i vodu,da se uskladi sa zakonskim dispozicijama na snazi, u roku od 30 dana od datuma prijema zahteva za ponovno razmatranje akta .

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS,

Kopija: *Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-e
Direktorima uprava i kancelarija
Arhivu MALS-e.*



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



KOMUNA E KAMENICËS
KUVENDI I KOMUNËS
01.Nr. _____, më 27.06.2012

QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA	
Sh. 01	Nr. 2624
U. _____	Br. _____
Nr. i flet. 2	Qend. 29/06
Br. i flet. _____	Qend. 2012

Në bazë të nenit 17 pika f) dhe 12 pika e) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 13 pika f) të Statutit të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.06.2012, m o r i

VENDIM
PËR KUFIZIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE ME PAGESËN E FATURAVE
PËR MBETURINA DHE UJË

I

Ky Vendim përcakton llojet e shërbimeve komunale që kufizohen nga organet e administratës komunale të Komunës së Kamenicës, përshkak të mospagesës së faturave për mbeturina dhe ujë.

II

Kufizimi i ofrimit të shërbimeve komunale nënkupton mosofrimin e një shërbimi të caktuar nga drejtoritë e administratës komunale ndaj personit fizik dhe juridik, deri në përmbushjen e detyrimit nga ana e tij.

III

Organet e administratës komunale kufizojnë ofrimin e shërbimeve të lidhura me pronën, biznesin, tenderët dhe ndërtimin nëse personi fizik ose juridik nuk paguan faturat e mbeturinave dhe ujit.

Ofrimi i shërbimeve në kuptim të këtij vendimi do t'iu ofrohet të gjithë personave fizik dhe juridik të cilët paguajnë shumën prej 40 % nga borgji i përgjithshëm.

Kushtëzimi nuk do të aplikohet ndaj qytetarëve të cilët nuk i shfrytëzojnë shërbimet lidhur me menagjimin e mbeturinave dhe furnizimin me ujë.

Me qëllim të arritjes së efekteve të dëshiruara, administrata komunale cakton një shërbyes civil në Qendrën për Shërbime të Qytetarëve, i cili duke u bazuar në shënimet që i ofron "Hidromorava" dhe "Higjena" lëshon vërtetime qytetarëve, si dëshmi mbi obligimet e kryera për mbeturina dhe ujë.

IV

Shërbimet e kufizuara përfshijnë:

1. Dokumentet pronësore, kadastrale dhe gjeodezike,

2. Përqimin për ndërrimin e destinimit të tokës.
3. Lejen për shfrytëzimin e pronës komunale.
4. Taksën për automjetet motorike.
5. Lejen e punës për veprimtaritë biznesor, lejet e punës për veprimtaritë profesionale dhe lejetimet e përkohshme të parapara me rregulloret komunale.
6. Tenderët e publikuar nga zyra e prokurimit.
7. Kushtet urbanistike, lejet për ndërtim, pranimin teknik të objekteve dhe lejet për demolim.

V

Kufizimi për mospagimin e detyrimeve të caktuar nuk mund të zbatohet mbi dokumentet personale të tilla si:

- a) çertifikata e lindjes,
- b) çertifikata e vdekjes,
- c) çertifikata e kurorëzimit,
- d) çertifikata mbi gjendjen e lirë martesore,
- e) çertifikata e statusit familjar,
- f) çertifikata e vendbanimit,
- g) çertifikata tjera të ngjajshme.

VI


Kufizimi i ofrimit të shërbimeve sipas këtij vendimi nuk do të zbatohet vetëm ndaj personave fizik të cilët janë nën asistencë sociale, Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës.


VII

Implementimin e vendimit e bëjnë drejtoritë komunale, ndërsa për zbatimin e tij kujdeset kryetari i komunës.

VIII

Me vendimin të njoftohen: Kryetari i komunës, kryesuesi, drejtorët e drejtorive komunale, "Hidromorava" njësia në Kamenicë, "Higjena" njësia në Kamenicë, Shërbimi Profesional i Kuvendit dhe Qendra për Shërbime të Qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

 Enver Mavriqi





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



KOMUNA E KAMENICËS
KUVENDI I KOMUNËS
01.Nr. _____, më 27.06.2012

QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANIN	
Sht. 01	Pr. 2624
U. _____	Zr. _____
Nr. i fto. 2	Data 29/06
Et. i d. _____	Data 2012

Në bazë të nenit 17 pika f), 11 dhe 12 pika e) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 13 pika f) të Statutit të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.06.2012, m o r i

VENDIM PËR KUFIZIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE ME PAGESËN E FATURAVE PËR MBETURINA DHE UJË

I

Ky Vendim përcakton llojet e shërbimeve komunale që kufizohen nga organet e administratës komunale të Komunës së Kamenicës, përshkak të mospagesës së faturave për mbeturina dhe ujë.

II

Kufizimi i ofrimit të shërbimeve komunale nënkupton mosofrimin e një shërbimi të caktuar nga drejtoritë e administratës komunale ndaj personit fizik dhe juridik, deri në përmbushjen e detyrimit nga ana e ujj.

III

Organet e administratës komunale kufizojnë ofrimin e shërbimeve të lidhura me pronën, biznesin, tenderët dhe ndërtimin nëse personi fizik ose juridik nuk paguan faturat e mbeturinave dhe ujit.

Ofrimi i shërbimeve në kuptim të këtij vendimi do t'iu ofrohet të gjithë personave fizik dhe juridik të cilit paguajnë shumën prej 40 % nga borghi i përgjithshëm.

Kushtëzimi nuk do të aplikohet ndaj qytetarëve të cilët nuk i shfrytëzojnë shërbimet lidhur me menagjimin e mbeturinave dhe furnizimin me ujë.

Me qëllim të arritjes së efekteve të dëshiruara, administrata komunale cakton një shërbyes civil në Qendrën për Shërbime të Qytetarëve, i cili duke u bazuar në shënimet që i ofron "Hidromorava" dhe "Higjena" lëshon vërtetime qytetarëve, si dëshmi mbi obligimet e kryera për mbeturina dhe ujë.

IV

Shërbimet e kufizuara përfshijnë:

1. Dokumentet pronësore, kadastrale dhe gjeodezike.